



Nëntor, 2021.

Nr.11

Zgjedhjet lokale 2021

Dy Raporte të miratuara për reklamat politike me pagesë për Zgjedhjet lokale 2021.

Këshilli i Agjencisë në nëntor miratoi dy Raporte për reklamat politike me pagesë programeve të radiodifuzerëve nga ku njëri për raundin e parë të kampanjës zgjedhore për Zgjedhjet lokale 2021 (nga 27 shtatori deri 15 tetor 2021), tjetri për raundin e dytë të kampanjës (nga 18 deri 29 tetor 2021). Në komunën Dibrës, raundi i dytë për zgjedhjen e Kryetarit të komunës së Dibrës u mbajt më 14 nëntor 2021 dhe për këtë arsye ishte përgatitur një Raport i veçantë shtesë përi emetimin e RPP në raundin e dytë të kampanjës zgjedhore për zgjedhjen e kryetarit në komunën e Dibrës që i referohet afatit kohor nga 1 deri 12 nëntor 2021. Në përputhje me Kodin zgjedhor, Raportet për reklamat politike me pagesë u dorëzuan pranë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Raport mbi mbulimin mediatic në raundin e dytë të fushatës për Zgjedhjet lokale 2021

Agjencioni më 5 nëntor publikoi raportin mbi mënyrën e raportimit të transmetuesve në raundin e dytë të fushatës zgjedhore (nga 18 shtator deri 29 tetor 2021). Monitorimi mbuloi gjithsej 13 shërbime programore – televizionet komerciale kombëtare Alsat-M, Alfa, Kanal 5, Sitel, Telma, 24 Vesti, 21-M, Shenja dhe Klan Maqedoni dhe kanalet programore të Shërbimit publik – MRT1, MRT2, Kanalini e Kuvendit dhe Programi i parë i radios Maqedonase (MRA1). Rezultatet e monitorimit treguan se nuk kishte shkelje të dispozitave të Kodit zgjedhor.

Edhe në raundin e dytë të fushatës, në emisionet ditore informative në plan të dytë mbeti pasqyra e përmbajtjeve konkrete të programeve zgjedhore për zhvillimin e komunave, dhe përmes raporteve, deklaratave, njoftimeve prioritet i'u dha zërave të (post) dueleve ndërpartiake të mitingjeve, dominuese të mishëruara në daljet publike të liderëve të LSDM-së, VMRO DPMNE-së, BDI-së, Besa dhe Koalicionin ndërmjet Aleancës së Shqiptarëve dhe Alternativa. Në lidhje me debatet, transmetuesit kombëtar ishin të interesuar për duelet për qytetin e Shkupit dhe për komunat e Shkupit – Qendër, Karposh dhe Çair, si dhe për komunat më të mëdha maqedonase – Manastir, Kumanovë, Tetovë, Kërçovë, Ohër dhe Gostivar, komuna që dhe nëpërmjet debateve të analistëve të skenës maqedonase politike u apostrofuan si çelës për pozicionin aktual, të qeverisë aktuale të koalicionit të LSDM-së dhe BDI-së. Intervistat edhe në raundin e dytë zgjedhor u treguan si një variant rezervë editorial për paraqitjen e ofertës politike, sepse disa transmetues u përballëshin ose me bojkot të hapur ose me arsye të tjera për shmangien e debatit të planifikuar. Informimi për njerëzit me aftësi të kufizuar shqisore ofruan vetëm MRT 1 dhe TV 24 Vesti.

Raporti mbi mbulimin mediatic në raundin e dytë të kampanjës për Zgjedhjet lokale 2021 dhe Raportet për reklamimin e paguar politik janë të disponueshme në banerin „Zgjedhje 2021“ në web faqen www.avmu.mk.

Nga 22 nëntori deri 2 nëntor u mbajt Dita e medias së shkruar 2021



Më 19 nëntor me pres-konferencë për media drejtori i Agjencisë dr.Zoran Trajčevski shënoi fillimin e manifestimit Ditët e medias së shkruar, të cilën Agjencia për shërbime mediatiche audio dhe audiovizuale dhe Rrjeti i medias së shkruar e organizuan në periudhën nga data 22 nëntor deri më 2 dhjetor 2021.

-Vendosja tematike e këtyre Ditëve buron nga zhvillimet e fundit në fushën e medias në vend – hyrja zyrtare e medias së shkruar në programet për arsimin fillor, si qasje në ligjëratat, për të cilën natyrisht kontribuan të gjitha përpjekjet e përbashkëta për të avancuar edukimin mediatic tek qytetarët e të gjitha gjeneratave, theksoi drejtori i Agjencisë.

Në kornizat e manifestimit, u mbajtën një sërë ngjarjesh dhe seminaresh kushtuar në ndërtimin dhe zhvillimin e vetëdijes kritike tek fëmijët dhe të rinjtë, por edhe tek grupet tjera qëllimore që kanë lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me ta.

Të gjitha informacionet lidhur me aktivitetet dhe ngjarjet e Ditëve, ishin ndarë nëpërmjet kanaleve për komunikim të Rrjetit në Twitter ([@MediumPismenost](https://twitter.com/MediumPismenost)), Instagram ([@mrezazamediumskapismenost](https://www.instagram.com/mrezazamediumskapismenost)), Facebook ([@MrezaZaMediumskaPismenost](https://www.facebook.com/MrezaZaMediumskaPismenost)) dhe në faqen web www.mediumskapismenost.mk.



NEWSLETTER

Debat i mbajtur onlajn për median e shkruar të ASHMA-së dhe Resis

Në korniza të Ditëve të medias së shkruar 2021, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale dhe Instituti Resis më 30 nëntor mbajti debat online me temë „Analiza e aspekteve gjinore në programet TV për fëmijë: „A ndërtojmë një ndërgjegje kritike tek fëmijët“?. Diskutimi përfshiu disa segmente, si psh. si është ndikimi psikologjik i programeve për fëmijët në rritjen dhe zhvillimin e tyre, deri tek mënyra e cila duhet për të krijuar politika dhe programe të mediave të destinuara për fëmijët. Duke bërë hyrje në debat dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë vuri në dukje se gjetjet treguan se Shërbimi publik udhëheq një program politik të planifikuar dhe të menduar për sa i përket popullsisë së fëmijëve, por ky konstatim është më shumë i vlefshëm për MRT1 dhe MRT2. Në lidhje me programet e televizioneve komerciale gjetjet treguan se nuk ekziston qasje e paramenduar dhe editorial i kujdesshëm në përzgjedhjen e emisioneve të destinuara për grupmosha të ndryshme të audiences për të mitur.

Në këtë ngjarje u prezantuan gjetjet e hulumtimit „Analiza e aspekteve gjinore në programet për fëmijë në televizionet nacionale toksore“ që ishte e bërë për nevojat e ASHMA-së. Rezultatet nga Analiza ishin pika nisëse për diskutim kualitet në të cilën morën pjesë disa përfaqësues të Shërbimit publik, shoqata qytetare dhe institucione. Pjesëmarrësit në debat ishin në pajtueshmëri se duhet shumë të punohet për krijimin e konceptit programor kualitativ dhe përmbajtjet që do të plotësojnë nevojat e fëmijëve dhe të rinjve dhe prej tyre do të krijojnë një audience që ka vetëdije kritike dhe arsimim mediatik.

Donacion nga ASHMA për të ndjerit dhe të lënduarit në aksident autobusi në Bullgari

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale më 23 nëntor njoftoi se ka vendosur të ndajë ndihmë finansiare për shtetasit e Maqedonisë që humbën jetën, si dhe për ata që janë lënduar në aksident autobusi që ndodhi në Republikën e Bullgarisë. Donacioni është në shumë prej 60.000 denarë për çdo të person të ndjerë. Për njerëzit që janë në trajtim spitalor, ndihma finansiare është në shumë prej 30.000 denarë.

Mjete finansiare do të paguhet përmes Kryqit të kuq të RMV. Agjencioni shprehu ngushëllime të thella për familjet dhe të afërmit e personave të ndjerë në këtë tragjedi, dhe të gjithë lënduarëve ju dëshiron shërim të shpejtë.

Donacion për transmetuesit duke ulur kompensimin e licencës për 2022

Për shkak të vazhdimit të pandemisë të COVID 19 e kishte ndikim të pafavorshëm në gjendjen e përgjithshme ekonomike, si dhe për shkak të shfaqjes së krizës energjetike që ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë ekonomike të transmetuesve, Agjencioni më 17 nëntor njoftoi se do të sigurojë ndihmë finansiare me qëllim që t'u ndihmojë radiove dhe televizioneve në trajtimin e pasojave negative.

Donacioni do të realizohet duke ulur kompensimin e tyre të licencës për televizion dhe radioi emetim për vitin 2020, i llogaritur sipas formulës së përcaktuar në LSHMAAV. Këtë ulje, duke pasur parasysh mundësitë finansiare të Agjencionit, arrin 50% e kompensimit të licencës. Agjencia shpreson se ky donacion do të kontribuojë në zbutjen e pasojave nga kriza dhe do të lehtësojë punën e transmetuesve, gjegjësisht do të kontribuojë në funksionimin normal të tyre për vitin e ardhshëm.

Njoftim për shtyp – Transmetuesit të përshtatin programin e tyre me ditët e zisë

Në lidhje me aksidentin e rëndë me autobus që ndodhi në Republikën e Bullgarisë, në të cilën humbën jetën një numër i madh i qytetarëve të Maqedonisë, Agjencioni u bëri thirrje mediave gjatë raportimit të respektojnë standardet profesionale gazetareske dhe principet, gjegjësisht informimi të jetë i çliruar nga senzacionalizmi dhe gazetarët të respektojnë dhimbjen personale dhe pikëllimin. Meqë Qeveria e RMV ditët nga 23 nëntori deri më 25 nëntor, i shpalli ditë zie, Agjencia i informoi transmetuesit se duhet të përshtatin programin dhe të emetojnë përmbajtje që sipas funksionit mediatik korrespondojnë me ditët e zisë.. Shfaqjet argëtuese, emisionet humoristike ose programet artistike të zhanrit komedi që ishin të planifikuara të transmetohen në tre ditët në vijim, të ndahen në ditët e tjera të javës në vijim, ndërsa muzika të jetë nga zhanret muzikore të përshtatashme për ditët e zisë, nëse këtë e lejojnë marrëveshjet e lidhura, rekomandohet që në tre ditët të mos transmetohen reklama.

Njoftim për shtyp

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale më 20 nëntor përmes një njoftimi për shtyp theksoi se është jashtëzakonisht e papërshtatshme sjellja e sigurimit në Qendrën tregtare të qytetit dhe tentimi të largohen gazetarët gjatë kohës së raportimit për takimin me pronarët e dyqaneve në QTQ, të cilët kërkuan hetim për rastin e kriptovalutave.

Në deklaratë theksohej se gazetaria investigative është thelbi i profesionit të gazetarit dhe kjo është vendimtare për realizim e rolit të medias në demokracitë moderne.



NEWSLETTER

Miramim i Udhëzuesit të ASHMA-së për monitorimin e zbatimit të standarteve për raportimin në rast të dhunës me bazë gjinore në media

Në seancën e 32-të të mbajtur më 9 nëntor, Këshilli i Agjencisë e miratoi [Udhëzuesin e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale për monitorimin e zbatimit të standardeve për raportimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore në media](#). Dokumenti është përgatitur nga një eksperte e angazhuar nga Këshilli i Evropës në kuadër të projektit “Liria e shprehjes dhe liria e mediave në Maqedoninë e Veriut” – JUFREKS 2, zbatuar nga Këshilli i Evropës dhe BE-ja. Udhëzuesi ndër të tjera synon t’i ofrojë medias dhe të gjithë palëve të interesuara, informacionet që u nevojiten për të perceptuar çështjen e raportimit të dhunës me bazë gjinore në tërësi.

Debat I hapur publik për tekstet e Draft – programit të punës së Agjencisë dhe Draft – planeve vjetore për mbikëqyrje administrative dhe programore për vitin 2022.

Më 17 nëntor, Agjencia hapi debat publik për tekstet e Draft – programit të punës së Agjencisë për vitin 2022. (me [Draft- programin i aktiviteteve të planifikuara dhe Draft- planin financiar i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale](#)), [Draft – plani vjetor për mbikëqyrjen administrative për vitin 2022](#). Agjencia ftoi të gjitha palët e interesuara me mendimet dhe propozimet e tyre në formë të shkruar, të marrin pjesë në debat publik dhe të njëjtat t’i dorëzojnë contact@avmu.mk ose në arkivin e Agjencisë. Debatin publik zgjat deri më 17 dhjetor 2021.

Mbikëqyrja e transmetuesve, ORRPKE dhe ofruesëve të shërbimeve mediatike audiovizive sipas kërkesës

Transmetuesit

Agjencioni kreu mbikëqyrje të rregullt administrative mbi të gjithë 111 transmetuesve që transmetojnë TV ose radio programë, për obligimin për publikim e të dhënave për strukturën e pronësisë, kryeredaktorin/readktorët dhe për burimet e financimit të vitit të kaluar më së voni deri më 31 tetor 2021.

Mbikëqyrja tregoi se vetëm Radio Lav nga Ohri nuk e ka përbushur obligimin nga neni 15 paragrafi 3 i Ligjit për media.

Mbikëqyrja e rregullt programore dhe administrative për respektimin e disa obligimeve ligjore është kryer mbi G-TV Televizioni, TV Kanal 8, TV Due, TV Gurra dhe TV Protel. Gjatë mbikëqyrjes e programit të G- TV Televizion ishte konstatuar mosrespektimi i rregullave për mbrojtjen e publikut minoren dhe përdorimi i gjuhës në program. Në programin e TV Due, është konstatuar mosrespektim i obligimeve për vendosjen e produktit, mos ofrimi i informacionit që duhet t’u vihet në dispozicion përdoruesve dhe mos publikimi i të dhënave që duhet të transmetohen në një vend të përshtatshëm për të cilin përmbajtje nga shërbimi programor. Tek TV Gurra është përcaktuar se nuk janë siguruar informacione që duhet të vihen në dispozicion të përdoruesve. Gjithashtu, TV G – TV, TV Due dhe TV Gurra nuk kanë transmetuar të 30% të programit burimor fillimisht në programin e tij.

Mbikëqyrja e jashtëzakonshme sipas detyrës zyrtare është kryer ndaj Siti televizionit gjë që tregoi se minimumi ligjor prej 30% i programit të krijuar fillimisht nuk u transmetua. Sipas detyrës zyrtare, është kryer mbikëqyrje e jashtëzakonshme administrative ndaj Radio Aktuel dhe TV Nova që tregoi se të dy transmetuesit nuk i plotësojnë kërkesat minimale të personelit të përcaktuara në Rregulloren për kushtete minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrove për marrjen e licencës për transmetim në radio dhe TV. Për shkak se edhe në afatin shtesë ligjor nuk harmonizuan veprimtarin e tyre në përputhje me Rregulloren, të dy transmetuesve iu janë është hequr licencat për transmetim në radio dhe TV. Pa kalimit të afatit për harmonizimin ligjor, Agjencia ka kryer mbikëqyrje programore kontrolluese dhe administrative për obligime të ndryshme ligjore ndaj TV Edo, Siti Televizion dhe TV Koha. Mbikëqyrjet treguan se edhe pas shqiptimi të masës vërejtje publike, Siti Televizion vazhdoi me mos respektimin e obligimit për mbrojtjen e publikut minoren, si dhe transmetimin më së paku 30% program burimor të krijuar.

Operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Mbikëqyrja e rregullt programore e detyrimeve lidhur me regjistrimin e shërbimeve programore në Agjenci dhe titrimi i programeve të ritransmetuara nga operatorët është kryer ndaj Biv Piramida, KDA- Kabel Net, Neotel, Skembi dhe Vinsat Kabel. Për detyrimet e operatorëve të ORRPKE-së, në apketën programore që ofrojnë detyrimisht dhe pa pagesë për të përmbajtur kanalet programore të shërbimit publik është kryer mbikëqyrje e rregullt programore për 9 operatorë. Mbikëqyrjet kanë konstatuar se këto obligime janë përbushur nga të gjithë operatorët që kanë qenë subjekt i mbikëqyrjes.

Ofruesit e ASHMA-së sipas kërkesës

Për obligimet për mbrojtjen e të miturve, bartjen e veprave kinematografike dhe promovimin e produksionit dhe qasjen në vepra evropiane, me kërkesë të A1 Maqedonija nga Shkupi është bërë mbikëqyrje e rregullt programore të ofruesit të ASHMA-së. Gjatë mbikëqyrjes nuk janë konstatuar shkelje.

